

I KËRKIMEVE DHE I POLITIKAVE MONETARE

DEPARTAMENTI

BANKA E SHQIPËRISË

Në ekonominë shqiptare gjatë periudhës së tranzicionit vendimet e individëve dhe të shoqërive tregtare filluan të kenë gjithnjë e më shumë peshë. Ndërthurja dhe ndërveprimi i këtyre vendimeve ndikojnë mbi variablat më të rëndësishëm të ekonomisë si inflacioni, prodhimi, punësimi dhe normat e interesit. Në këtë mjedis banka qendrore duhet të përdorë instrumentin e saj bazë- përqindjen e normës së interesit të repove njëjavore – për të siguruar përmbushjen e objektivit kryesor të saj – arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Në këtë kuadër, luajnë rol të rëndësishëm analiza e politikave dhe kërkimet shkencore. Qëllimi i tyre është që të kuptohet sa më mirë se si funksionon ekonomia.

Analiza politike dhe kërkimet në Bankën e Shqipërisë kryhen nëpërmjet dy sektorëve: Sektori i Ekonomisë dhe Sektori Financiar. Sektorët janë përgjegjës për paraqitjen tek autoritetet vendimmarrëse të të dhënave ekonomike dhe financiare dhe për analizën e tyre. Për të realizuar këtë detyrë, është e nevojshme të zotërohet një bazë sa më e mirë të dhënash dhe informacioni. Për këtë arsye, Departamenti është i angazhuar edhe në sigurimin e informacionit statistikor si nëpërmjet rrjetit të agjencive publike (ose shtetërore) ashtu edhe nga sektori privat i ekonomisë nëpërmjet vrojtimeve. Departamenti është, gjithashtu, përgjegjës për raportimin publik të të dhënave statistikore dhe rezultateve e konkluzioneve të analizave dhe studimeve. Për të realizuar këtë raportim, Departamenti është i angazhuar në përgatitjen e botimeve të ndryshme periodike dhe joperiodike dhe të atyre me karakter teknik që destinohen për një grup të ngushtë përdoruesish profesionistë apo me karakter shpjegues që destinohen për publikun në tërësi. Botimet shpjeguese përgatiten në bazë të strategjisë së përcaktuar nga Banka e Shqipërisë për të nxitur edukimin e publikut me çështje të natyrës ekonomike dhe financiare. Po në këtë kuadër, biblioteka e Bankës së Shqipërisë, shërben jo vetëm për punonjësit e saj por është e hapur edhe për publikun.

Departamenti i Kërkimeve dhe i Politikave Monetare u krijua në prill të vitit 2001 nga bashkimi i Departamentit të Kërkimeve (krijuar në mars 1998) dhe Departamentit të Politikave Monetare (krijuar në gusht 1992).

Përmbushja e funksioneve kërkimor dhe analizues, u konceptua në varësi të njëri-tjetrit. U përmirësua procesi analizues i fenomeneve si në vëllim ashtu edhe në cilësi. Ai u bë më i rrjedhshëm e logjik. Nga ana tjetër, puna kërkimore angazhoi gjithnjë e më shumë burime njerëzore mjaft cilësore në departament. U trajtuan dhe u studiuan probleme dhe çështje me rëndësi jetike në veprimtarinë e bankës qendrore, u dhanë rekomandime dhe rrugëzgjdhje konkrete për daljen apo përballjen e situatave të ndryshme ekonomike në vend. Puna kërkimore gjatë kësaj kohe shënoi hapat e parë drejt teknikave konkrete parashikuese për tregues të rëndësishëm makroekonomikë.

1. Do të veçohej kontributi i kërkimeve në fushën e eksplorimit të:

- sjelljes së inflacionit dhe parashikimit të tij për periudha afatshkurtra;
- inflacionit të mallrave të tregtueshëm dhe të patregtueshëm;
- sjelljes së kursit të këmbimit dhe faktorëve përcaktues të tij;
- analizës së eksporteve dhe importeve;
- pavarësisë së bankës qendrore dhe transparencës së saj;
- sistemit bankar në tërësi;
- etj..

2. Kryerja e vrojtimeve statistikore për qëllime të veçanta studimore, përpunimi dhe analiza e informacionit të vjelë prej tyre, përmirësuan ndjeshëm aspektin statistikor dhe analizues të punës në departament.

3. Zgjerimi i aktivitetit publikues dhe rritja e cilësisë së produkteve të publikuara ndihmuan konkretisht në ngjitjen e shkallëve drejt një banke qendrore transparente dhe të pavarur. Roli edukues i saj për problemet e rëndësishme të ekonomisë në tërësi dhe të asaj shqiptare në veçanti u përvijua nëpërmjet serisë së botimeve periodike dhe speciale, që gjatë gjithë kësaj kohe u përsosën. Nga disa faqe sot nga departamenti prodhohen rreth 200 faqe në muaj.

4. Synimet për të ardhmen:

• projektet kërkimore do të kenë si objekt kryesor stabilitetin monetar dhe atë financiar, me qëllim kryesor rritjen e aftësisë parashikuese të modeleve të propozuara;

• për periudhën afatmesme Banka e Shqipërisë do të vijojë të mbështetet në regjimin e politikës monetare të quajtur "*monetary targeting*". Megjithatë, kjo kohë do të jetë një periudhë përgatitore aktive për adoptimin e regjimit "*inflation targeting*";

• intensifikimi i aktivitetit edukues të publikut për të perceptuar dhe për të kuptuar gjerësinë dhe thellësinë ekonomike të koncepteve të tilla si kursimet, investimet, si edhe atë të rolit të bankave si ndërmjetëse financiare. Aktiviteti publikues do të synojë drejt këtyre akteve kryesore:

- rritjen e publikimeve joperiodike, për aspekte të veçanta ekonomike;
- shtimin e publikimeve me rol edukues;
- shtimin e publikimeve të ofruara në gjuhë të huaj;
- shtimin e përdoruesve të publikimeve;
- vijimin e ofrimit të publikimeve falas;

• përsosja strukturore e departamentit për të thithur dhe për të drejtuar punën e stafit të tij në proceset parashikuese dhe modeluese, fakt që do të shërbejë në vënien me efikasitet të lartë të konkluzioneve dhe analizave në shërbim të procesit vendimmarrës.